



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 99 Prot.

Tiranë, 23 / 08 2023

Lënda: Mbi përgjigjen e dhënë nga Prokuroria e Përgjithshme për verifikimin e kandidatëve nga rradhët e avokatisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Z. Genci GJONÇAJ
Sekretari i Përgjithshëm

Për dijeni: Znj. Klotilda BUSHKA
Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Kuvendi i Shqipërisë
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
TIRANË

Të nderuar,

Siç jeni në dijeni, Avokati i Popullit në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është duke zhvilluar procedurat që lidhen me verifikimin paraprak nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc të plotësimin të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndër kompetencat specifike që i ngarkohen Avokatit të Popullit në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc janë edhe kompetencat e renditura në pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 31, si dhe në pikën 2, 3, 4, të nenit 129 të ligjit të sipërcituar.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 dhe pikës 2 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i Komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme, formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Prokuroria e Përgjithshme, kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve"*, Avokati i Popullit me shkresën nr.93, datë 16.08.2023, të cilën e gjeni bashkëlidhur, i kërkoj Prokurorit të Përgjithshëm, që mbi bazën e formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatët që kanë aplikuar nga rradhët e avokatisë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët u dërguan bashkëngjitur shkresës, të kryhej verifikimi i formularëve përkatës brenda afateve të parashikuara ligjore.

Me shkresën nr.1313/1, datë 21.08.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka kthyer përgjigje duke theksuar, ndër të tjera, se në përputhje me ligjin nr.138/2015, "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, "*Për përcaktimin e rrugullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, janë ngarkuar specifikisht organet përgjegjëse për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit (në rastin konkret, sipas tyre, titullari i Komisionit të Pavarur Ad Hoc), të cilët duhet të verifikojnë paraprakisht të dhënat e deklaruara, dhe se Prokuroria e Përgjithshme investohet vetëm kur ka nevojë për verifikime të thelluara. *Për më shumë, bashkëlidhur do të gjeni shkresën e dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe argumentet e paraqitura prej saj.*

Një qëndrim i tillë institucional i Prokurorisë së Përgjithshme krijon realisht pengesa serioze në punën dhe mbarëvajtjen e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, veçanërisht sa i përket procesit të vlerësimit të kandidatëve nisur nga kriteret profesionale dhe morale të përcaktuara nga ligji si dhe renditjen e tyre bazuar në këto kritere.

Kjo, *së pari*, për shkak se Komisioni i Pavarur Ad Hoc nuk disponon kapacitetet e nevojshme për të kryer apo marrë përsipër verifikimin paraprak të të dhënave të deklaruara nga kandidatët në formularët e vetëdeklarimit. Kjo ka qenë dhe një nga arsyet që në vitin 2017, ku u zhvillua për herë të parë ky proces, verifikimi paraprak apo i thelluar i të dhënave të deklaruara nga kandidatët në formularët e vetëdeklarimit u realizua nga një institucion i vetëm, pikërisht nga Prokuroria e Përgjithshme.

Së dyti, dispozitat e sipërcituara të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, i ndryshuar, përcaktojnë se "*Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i Komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme, formularët e vetëdeklarimit....."*, çka nënkupton qartësisht se ligjvënësi këtë detyrim, në kuadër të këtij procesi, ia ka atribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të plotë vetëm Prokurorisë së Përgjithshme.

Kërkojmë të sjellim në vëmendje, se procedura paraprake, që Avokati i Popullit po kryen këtë proces për llogari të përzgjedhjes përfundimtare të bërë nga Kuvendi. Po ashtu verifikimi përfundimtar i procesit kryhet nga Kuvendi e për këtë duam që të kemi kuptim të njëjtë të ligjit dhe zbatim efektiv të tij.

Në referencë të arsyetimit të sipërcituar si dhe për shkak të rëndësise që ka ky proces verifikimi, në kuadër të vlerësimit të kriterëve morale të kandidatëve, Avokati i Popullit do të kërkonte ndërhyrjen e Kuvendit të Shqipërisë pranë këtij institucioni për t' i rikujtuar rëndësinë që ka kryerja me prioritet e verifikimeve përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe mbështetjen Tuaj,

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

